



Av. Lorenc Gordani, PhD

**Përgjegjës i Departamentit të Drejtësisë
Fakulteti i Biznesit dhe Drejtësisë
Tirana Business University College**

Lorenc Gordani është Përgjegjës i Departamentit të Drejtësisë në Fakultetin e Biznesit dhe Drejtësisë, pranë Tirana Business University College, TBU. Ai është njëkohësisht këshilltar në projekte të nivelit të lartë për Politikën dhe Kuadrin Ligjor, Rregullator dhe Infrastrukturalin e Energjisë në Shqipëri.

Formimi i lartë universitar (Laurea Magistrale në Universitë degli Studi di Torino) dhe Doctorate of Philosophy në të Drejtën Publike (Universitë degli Studi di Pavia), si dhe formimi i vazhdueshëm i mëtejshëm është zhvilluar tërësisht në Itali (Diplomë pasuniversitare në Shkenca Ndërkombëtare dhe Diplomaci, Diploma në Studime të Avancuara Evropiane (DASE) Kolegji Evropian i Parmës, etj.), Placement, Universitë de Nantes France, Leuphana Universität Lüneburg Gjermani, si dhe qendra të tjera të mëdha në Evropë.

Pas përfundimit të studimeve të larta, veprimtaria kryesore profesionale e Dr. Gordanit ka vazhduar në mjedise të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, me mësimdhënie akademike, trajnime në formate të ndryshme, kërkime të aplikuara, si dhe për organizatat ndërkombëtare dhe autoritetet publike, apo për kompani të huaja dhe vendase, përmes konsulences strategjike, ngritjen e kapaciteteve institucionale, etj.

Puna e Dr. Gordanit është fokusuar në zbatimin e kuadrit ligjor të BE-së në Shqipëri dhe politikën publike që lidhen me industrinë dhe grupet e interesit, institucionet ndërkombëtare dhe autoritetet publike. Veprimtaria e gjerë rreth 20 vjeçare, e ndjekur me synimin për të nxitur çështje që lidhen me rritjen e qëndrueshme në Shqipëri, janë shoqëruar me botimin e një bibliografie të gjerë, pjesëmarrje të vazhdueshme si analist në media, folës në shumë konferenca ndërkombëtare, etj.